

SBASHK Arsimimi sot

Mars, 2025

Gazeta elektronike

Përfaqësuesit e SBASHK-ut takohen me udhëheqës të EI-së dhe ETUCE-së



Nënkryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymeri Ymeri, në kuadër të vizitave jashtë vendit, ka qëndruar në Bruksel ku ka takuar Sekretarin e Përgjithshëm të Edukimit Ndërkombëtar (EI), z. David Edwards, të shoqëruar nga Kryetari i ETUCE, z. John MacGabhann... (faqe 8)

SBASHK përfaqësohet në Takimin e Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (HERSC) në Bruksel



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, me ftesë të kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, u pritën nga ky i fundit gjatë muajit dhjetor të vitit 2024 ... (faqe 8)

SBASHK mirëpret Federatën Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë, nënshkruan edhe një marrëveshje bashkëpunimi



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, SBASHK gjithashtu ka mirëpritur udhëheqësit e Federatës Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë... (faqe 9)

Intervistë me kryetaren e sapo zgjedhur të Shoqatës Sindikale në shkollën “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë të Klinës



Mësuesja e ciklit klasor në këtë shkollë, znj. Kristina Gojani... (faqe 3)

SBASHK uron 7 Marsin, Ditën e Mësuesit



Të dashur mësime, Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, SBASHK-u ju përcjell urimet më të përzemërta dhe mirënjohjen e pakufishme... (faqe 7)

Editorial

“7 Marsi”, Dita e Mësuesit



Çdo herë muaji mars na sjell në mendje mësimdhënësin shqiptar, në veçanti atë në Kosovë dhe “Ditën e Mësuesit” e cila shënohet për nder të tij.

Që nga hapja e mësonjëtores së parë shqipe në Korçë, më 1887, 7 Marsi pati një simbolikë të veçantë tek shqiptarët, duke e përkujtuar dhe nderuar sakrificën e të gjithë mësimdhënësve të cilët edukuan breza të tërë me dije e shkollim.

Ndërsa në Kosovë, 7 Marsit apo “Ditës së Mësuesit”, ia shtoi vlerën edhe më shumë periudha e okupimit nga pushtuesi serb, kur mësimdhënësit shqiptar sakrifkuan edhe jetën e tyre, të dëbuar nga objektet mësimore-shkollat, e vazhduan punën nëpër shkollat shtëpi, vetëm e vetëm që zingjiri arsimor i gjeneratave të tëra të mos shkëputej dhe që gjenerata të tëra mos të ngelnin analfabetë.

Megjithatë, mësimdhënësi në Kosovë, edhe 26 vjet pas çlirimit nga okupatori serb dhe 17 vjet nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës, vazhdon të mos i gëzojë benefitet e punës, siç është njohja e përvojës së punës dhe pensioni kontributdhënës bazuar mbi këtë përvojë.

Mësimdhënësi dhe roli i tij në shoqëri ka degraduar edhe më shumë vitet e fundit në Kosovë, kur me greva e protesta të shumta mësimdhënësi kërkoi kushte më të mira të punës dhe pagë më të dinjitetshme, e të cilat të drejta nuk po i gëzon as sot. Urojmë që 7 Marsi i ardhshëm ta gjej në një pozitë të lakmueshme profesionin e mësimdhënësit fillimisht si dhe pozitën e mësuesit në veçanti.

Grevat e protestat në arsim mos u përsëritshin asnjëherë, por nëse nuk ka rrugzgjdhje tjetër, veprimet sindikale do të vazhdojnë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotet në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me kryetaren e sapo zgjedhur të Shoqatës Sindikale në shkollën “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë të Klinës



Bisedë me veprimtarin sindikal Fejzullah Në Gazetën mujore të SBASHK-ut për muajin mars, mund të lexoni intervistën me kryetaren e re të zgjedhur në Shoqatën Sindikale “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë të komunës së Klinës, znj. Kristina Gojani.

Mësuesja e ciklit klasor në këtë shkollë, znj. Kristina Gojani, ka treguar në këtë numër të gazetës rreth zgjedhjes së saj në krye të nivelit të Shoqatës Sindikale, procesit të zgjedhjeve dhe synimet që ka ajo si udhëheqëse e SBASHK-ut në këtë nivel sindikal.

Kur janë mbajtur zgjedhjet në shkollën “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë të Klinës dhe si ka kaluar procesi zgjedhor?

Kristina Gojani: Zgjedhjet janë mbajtur në shkollën “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë të Klinës. Procesi i zgjedhjeve ku unë jam zgjedhur kryetare e Shoqatës Sindikale ka qenë me vota të fshehta. Në procesin zgjedhor ka pas kandidatë dhe kundërkandidatë, është votuar në atë formë që cdo gjë ka shkuar në rregull dhe procesi është zhvilluar me votim të fshehtë. Unanimisht jam votuar unë nga shumica e kandidatëve dhe kam marrë detyrën e re në këtë pozitë të SBASHK-ut. Zonja Gojani ka treguar për lexuesit e SBASHK-ut

se shkolla ku ajo mban mësim, është shkollë e nivelit Fillor dhe të Mesëm të Ulët, pra klasat 1 deri 9, derisa personalisht është mësuesja e cililit klasor.

Si shqetësim për mësuesen Gojani është numri në rënie i nxënësve, kur këtë vit për herë të parë nuk ka klasë të parë për shkak të mungesës së nxënësve.

Kristina Gojani: Numri i nxënësve është gjithëmonë në rënie e sipër, klasë të parë këtë vit nuk ka fare për shkak të mungesës së nxënësve, vitin tjetër ndoshta do të ketë. Në shkollën ku unë punoj me ciklin klasor, i kemi rreth 70 nxënës gjithsej.

Cilat janë synimet tuaja për mandatin 4 vjeçar?

Kristina Gojani: Shpresoj që në bashkëpunim me nivelin komunal dhe atë qendror të SBASHK-ut, të arrijmë t’i mbrojmë të drejtat e mësuesve, t’u ndihmojmë dhe t’u krijojmë lehtësira në aspektin e realizimit të synimeve të tyre, qoftë me përkrahje nga ana e Sindikatës, adresim të nevojave të mësuesve. Po ashtu, një nga synimet kryesore është edhe zhivllimit profesional, duke u mundësuar mësuesve vijimin apo ndjekjen e programeve të ndryshme të trajnimeve të cilat aktualisht i ofron SBASHK-u për mësuesit anëtar.

Sa janë kërkesat e mësuesve për zhvillim profesional si dhe ndjekje të trajnimeve?

Kristina Gojani: Interesimi për ndjekje të trajnimeve nga ana e mësuesve të shkollës sonë është shumë i madh dhe këtë e shoh edhe praktikisht, pasi jam edhe studente në nivelin Master në Edukim Inkluziv dhe e shoh që interesimi për trajnime është jashtëzakonisht i madh. Kjo duke pas parasysh faktin se në shkollën tonë, nveli 1-5 i mësuesve, ka pak mësues të rinjë dhe ka shumë të interesuar për trajnime.

Cilat janë kërkesat kryesore të mësuesve?

Kristina Gojani: Mësuesit presin që të realizohen pagesat e pensioneve, rimbursimi i punës për vitet ‘90, kontrata kolektive, etj. Po ashtu pres që kemi me pas mirkëuptim dhe përkrahje maksimale në mes të nivelit lokal dhe atij qendror të SBASHK-ut në mënyrë që kërkesat e mësuesve të adresohen dhe të realizohen mesiguri me kohë.

Gjatë muajit


SBASHK gjatë muajit mars organizoi dhjetëra grupe të trajnimit në mbarë Kosovën
Jasharaj i vizitoi mësimdhënësit të cilët e ndoçën trajnimin në Prishtinë



SBASHK i ka organizuar dhjetëra grupe të trajnimit në programet, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në mbarë Kosovën.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i kishte vizituar mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku kishin filluar tri grupe njëherazi, dy në Qendrën Burimore “Përparimi” dhe një grup në shkollën “Dardania” në Prishtinë.



Gjatë vizitës së tij, Jasharaj ishte informuar nga afër me procesin e trajnimit që po zhvillohej në Qendrën Burimore “Përparimi”, ku po mbahehsin dy grupe të trajnimit

paralelisht, njëri të shtunën dhe tjetri të dielën, nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Nexhmedin Gruda.

Jasharaj pati rast të diskutoj nga afër me mësimdhënësit që po e ndiqnin këtë trajnim, të njihet nga afër me problemet, kërkesat dhe shqetësimet që i preokupojnë ata si dhe u ofroi mbështetjen e SBASHK-ut si çdoherë.

SBASHK gjatë muajit mars ka organizuar 14 grupe të trajnimit, një në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” dhe 13 në atë “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Në Rahovec ishte mbajtur një grup i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, duke filluar nga 1 marsi 2025, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Ermal Ahmetaj.

Mësimdhënësit në Rahovec, ishin vizituar edhe nga nëkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe kryetari i SKAP-it për Rahovec, Veli Morina.



Ndërkohë, gjatë këtij muaji janë mbajtur dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Klinë, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha, kurse në Malishevë u mbajt trajnimi në të njëjtin program me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Albert Samadraxha.



Mësimdhënësit janë shprehur mirënjohës për mundësinë e ofruar nga SBASHK, duke ndjekur trajnime të cilat për ta janë të nevojshme për avancim por edhe janë shprehur të gatshëm të rrisin njohuritë e tyre profesionale në fushën e arsimit.



Në kuadër të përpjekjeve për ngritje profesionale të mësimdhënësve, në Gjakovë gjatë muajit mars, SBASHK mbajti një grup të trajnimit, po në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajneren e përzgjedhur nga SBASHK, Litvana Spahija.

Kurse në Suharekë, gjatë muajit mars u mbajtën katër grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Bahrije Elshani, Skender Gashi dhe Emin Hoxha, i cili i mbajti paralelisht dy grupe të trajnimit me mësimdhënës.



Komuna e Dragashit po ashtu gjatë këtij muaji e organizoi një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajner Vloran Krasniqi.



Ndërkohë, dy grupe të trajnimit u mbajtën gjatë muajit mars edhe në Ferizaj në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Xhemil Halili dhe Arsim Qalaj.

Edhe në Lipjan gjatë muajit mars u mbajt trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Idriz Sopa, kurse në Shtime dhe Gjilan filloi nga një grup i trajnimit në programin e njëjtë, me trajner, Ferid Shaqiri, respektivisht Musli Neziri.



Gjatë muajit mars 2025, SBASHK ka organizuar edhe një mori testesh për mësimdhënësit të cilët e kanë ndjekur dhe përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Nën administrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të SBASHK-ut, Ymer Ymeri dhe Nënkryetares Vjollca Shala, testimet u zhvilluan në Suharekë, në një atmosferë profesionale dhe të organizuar, duke vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e fituara nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit.

Trajnimi ishte mbajtur nga trajnerët Skender Gashi dhe Bahrije Elshani dhe ka pasur për synim të pajisë mësimdhënësit me aftësi të avancuara në përdorimin e teknologjisë në procesin e mësimdhënies. SBASHK po vazhdon të organizojë këto trajnimet si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për të ndihmuar mësimdhënësit të jenë më të përgatitur për sfidat e mësimdhënies moderne.

Ky aktivitet është një dëshmi e përkushtimit të SBASHK-ut për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe për avancimin e sistemit arsimor në Kosovë.



Në kuadër të këtij qëllimi, edhe në Gjilan u mbajtën testet për dy grupe të mësimdhënësve në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, nën administrimin e Sekretarit të Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, ku trajnere ishte Ibadete Limani.



Gjatë vikendeve të këtij muaji, nën administrimin e Nënkryetares së SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarit ligjor, Blendor Shatri, u mbajtën testet edhe për mësimdhënësit në Gjakovë, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Litvana Spahija.

Testi për një grup të mësimdhënësve që ishte udhëhequr nga trajneri Albert Samadraxha u mbajt edhe në Malisheve si dhe në Rahovec, ku trajneri i përcaktuar nga SBASHK ishte Ermal Ahmetaj.

SBASHK në Podujevë mbajti testet për dy grupe të mësimdhënësve kurse shpërndau certifikatat për tri grupe që e i kishin përfunduar më parë trajnimet. Testet në Podujevë u administruan nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, derisa udhëheqës i trajnimit me katër grupe të mësimdhënësve në Podujevë, ishte trajneri Kadri Hyseni.



Po ashtu, të shtunën në Podujevë u shpërndanë edhe certifikatat për tri grupe të mësimdhënësve të cilët i kanë përfunduar gjatë muajit shkurt trajnimet: dy në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajner Kadri Hyseni dhe një grup i certifikatave në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnere Nora Haliti.



Gjatë muajit mars, SBASHK ka mbajtur edhe një grup të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në komunën e Rahovecit, i cili është udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Testet për mësimdhënës gjatë këtij muaji u mbajtën edhe në Prishtinë ku trajner ishte Arben Zymeri dhe Fushë-Kosovë, me trajnere Blerona Ahmeti. Testet në këto dy grupe u administruan nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri si dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.



SBASHK uron 7 Marsin, Ditën e Mësuesit



Të dashur mësimdhënës,

Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, SBASHK-u ju përcjell urimet më të përzemërta dhe mirënjohjen e pakufishme për punën tuaj të palodhur dhe përkushtimin e treguar ndër vite në edukimin e gjeneratave të reja. Falë angazhimit tuaj, sot kemi shumë doktorë shkencash, mjekë, juristë, gjykatës, prokurorë dhe profesionistë të shumtë në fusha të ndryshme, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë sonë.

Në veçanti, dëshirojmë të nderojmë kontributin tuaj gjatë viteve të vështira 1990-1999, kur, përballë sfidave të mëdha, u dëbua nga shkollat dhe mbetët pa paga. Megjithatë, ju vazhduat misionin tuaj fisnik pa u ndalur as edhe një ditë, duke edukuar brezat e rinj në kushte të vështira. Një numër i konsiderueshëm prej jush iu bashkua radhëve të UÇK-së, duke kontribuar në çlirimin e vendit tonë. Kjo datë korrespondon edhe me epopenë e UÇK-së, duke e bërë atë edhe më domethënëse.

Megjithatë, ndiejmë një shqetësim të thellë që shteti ynë aktualisht nuk e njeh plotësisht këtë kontribut të jashtëzakonshëm të viteve '90. Si rezultat, disa nga ju po dilni në pension duke marrë vetëm pensionin e pleqërisë, pa u vlerësuar si duhet me pensionin kontributdhënës që meritoni. SBASHK-u do të vazhdojë të angazhohet për të drejtat tuaja dhe për njohjen e plotë të kontributit tuaj të çmuar.

Edhe njëherë, ju urojmë Ditën e Mësuesit dhe ju falënderojmë për gjithçka që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për arsimin dhe shoqërinë tonë.

Me respekt dhe mirënjohje,
SBASHK-u,

7 mars 2025

UDHETIME JASHTË VENDIT

Udhëheqësit e SBASHK-ut realizuan disa vizita jashtë vendit gjatë muajit mars, takuan udhëheqës të sindikatave evropiane e botërore të arsimit.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut takohen me udhëheqës të EI-së dhe ETUCE-së



Delegacioni i SBASHK-ut, i përbërë nga Nënkryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymeri Ymeri, në kuadër të vizitave jashtë vendit, ka qëndruar në Bruksel ku ka takuar Sekretarin e Përgjithshëm të Edukimit Ndërkombëtar (EI), z.

David Edwards, të shoqëruar nga Kryetari i ETUCE, z. John MacGabhann. Gjatë këtij takimi u diskutua mungesa e dialogut social në Kosovë, angazhimi i vazhdueshëm i SBASHK-ut për mbrojtjen dhe promovimin e anëtarësisë, si dhe mbështetja që institucionet EI dhe ETUCE po ofrojnë organizatave anëtare, duke përfshirë edhe SBASHK-un.

Z. Edëards ka përgëzuar SBASHK-un për punën e rëndësishme në Kosovë, duke theksuar pjesëmarrjen aktive në takimet ndërkombëtare të EI dhe ato evropiane të ETUCE, ku instituti ka dhënë kontribut në çështje kyçe. Ai ripërsëriti angazhimin e EI-së dhe theksoi se do të mbetet gjithmonë krah i SBASHK-ut për të siguruar përfaqësim në çdo forum, si në nivel botëror ashtu edhe në atë evropian,

duke bashkëpunuar në fushatën për mbrojtjen e arsimit publik në Kosovë.

Gjatë ditës, delegacionin e SBASHK-ut e priti edhe një takim në zyrën e tij, Drejtori i ri i ETUCE-se, z. Jelmer Evers, ku u diskutua fillimi i punës së tij, vendim i cili po përgatitet për vitin 2025. Në këtë rast, u shprehu edhe mbështetja e SBASHK-ut për aktivitetet që po ndërmerren në përkrahje të anëtarësisë, si dhe për mundësinë që, sa më e afërt të jetë e mundur, të vizitohet Kosova.

Delegacioni i SBASHK-ut falënderon z. Edwards për mbështetjen që EI ka ofruar SBASHK-ut edhe përpara viteve '90, dhe sidomos për periudhën menjëhershme pas luftës, kur u ndërtonin dhe pajiseshin shkollat e para që ishin djegur gjatë konflikteve në Kosovë.

Gjithashtu, shprehet mirënjohja e përjetshme për Sekretarin e Përgjithshëm të atëhershëm, z. Fred Van Leeuën, i cili ka qenë gjithmonë në krah të SBASHK-ut në ditët më të vështira për popullin e Kosovës.



SBASHK përfaqësohet në Takimin e Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (HERSC) në Bruksel

Po ashtu, udhëheqësit e SBASHK-ut qëndruan në Bruksel ku u mbajt Takimi i Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (HERSC), i cili u hap nga Kryetari i Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE), z. John MacGabhann. Në fjalimin e tij, ai uroi punë të mbarë anëtarëve të HERSC-it për mandatin e tyre katërvjeçar.



Në këtë takim mori pjesë edhe Drejtori i ETUCE-së, z. Jelmer Evers, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për avancimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në nivel evropian.

SBASHK-u ishte përfaqësuar në këtë komitet nga Nënkryetarja e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, e cila është anëtare e HERSC-it. Gjatë ditës së parë të takimit, komiteti kishte zgjedhur Kryetarin dhe Nënkryetarin e ri të HERSC-it për një mandat katërvjeçar.



Në këtë ngjarje të rëndësishme mori pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, i cili së bashku me Nënkryetarën e SBASHK-ut znj. Vjollca Shala, kanë zhvilluar edhe një takim të veçantë me Sekretarin e Përgjithshëm të Education International, z. David Edwards. Ky takim kishte për qëllim që të trajtojë çështje kyçe mbi të drejtat e punëtorëve të arsimit dhe zhvillimet e fundit në politikat arsimore ndërkombëtare. Në kuadër të takimit të HERSC-it ishin diskutuar çështje të rëndësishme për të ardhmen e arsimit të lartë, përfshirë:

- Sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe standardet evropiane
- Politikat e BE-së për financimin e arsimit dhe ndikimi i tyre

SBASHK mirëpret Federatën Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë, nënshkruan edhe një marrëveshje bashkëpunimi



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, SBASHK gjithashtu ka mirëpritur udhëheqësit e Federatës Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë, me të cilët ka lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi, e cila parasheh ndër të tjera: bashkëpunimin në reformat arsimore, angazhimin për financim të qëndrueshëm të arsimit, harmonizim të politikave dhe objektivave sindikale bashkëpunim për trajnimin profesional dhe sindikal, dhe disa pika tjera.



- Kriza financiare, kursimet buxhetore dhe efektet e tyre në universitetet publike
- Angazhimi i sindikatave për të kundërshtuar shkurtimet dhe për të siguruar investime në arsim
- Fushata “Go Public, Fund Education” e Education International
- Shembuj nga vende të ndryshme mbi ndikimin e politikave financiare në arsimin e lartë

SBASHK vazhdon të mbetet një zë i fuqishëm në mbrojtjen e të drejtave të mësimitdhënësve dhe punëtorëve të arsimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke qenë pjesë aktive e vendimmarrjes në politikat arsimore në Evropë.

Nënkyetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, së bashku edhe me kryesinë, fillimisht kishin zhvilluar një takim pune me udhëheqësit e FSASH-së, të cilët ishin mirëpritur në zyrat e SBASHK-ut në Prishtinë.



Kryetari i FSASH-së, Shpetim Brahaj, Nënkyetarja Blerina Qemali, Sekretari Organizativ, Bashkim Shyle dhe anëtarja e Këshillit Drejtues, Brikela Zeqollari, fillimisht kishin zhvilluar takim edhe me Këshillin Drejtues të SBASHK-ut, ku kishin diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në fushën e arsimit, në fuqizimin e bashkëpunimit sindikal dhe forcimin e rolit të mësimitdhënësit në dy shtetet simotra, për të mbyllur ditën me një darkë të përbashkët ndërmjet delegacioneve të të dyja vendeve.



Në ditën e dytë të vizitës së sindikalistëve shqiptarë, SBASHK kishte organizuar edhe disa takime në Pejë, Prizren e Klinë, ku delegacioni nga Shqipëria ishte takuar me udhëheqësit e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Pejë, duke u pritur nga drejtori komunal i Arsimit, Naser Gega për të vizituar më pas shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Xhemal Kada” në Pejë si dhe udhëheqësit sindikal të komunës së Pejës.

Përfaqësuesit e Sindikatës së Shqipërisë, gjatë rrugës për në Pejë, kishin vizituar shkollën Filllore të Mesme të Ulët, “Azem Bejta” në Klinë, ku ishin pritur nga kolektivi i shkollës, derisa në shkollë, për hirë të mysafirëve, kishte shkuar edhe Drejtori i Arsimit të kësaj komune, Qemail Sejdiu.

Pas Pejës, përfaqësuesit e Shqipërisë kishin vizituar edhe shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Emin Duraku” në Prizren, ndërsa më pas ishin pritur nga drejtoresha për Arsim në këtë komunë, Luljeta Veselaj Gutaj.

Vizita në Kosovë e delegacionit shqiptar, ishte përmbyllur me vizitën nëpër shkollat e Kosovës ku ishin takuar me mësimdhënësit e këtyre institucioneve.



SBASHK mbajti takimin e Këshillit Drejtues, ku u shpall edhe viti zgjedhor



SBASHK gjatë muajit mars ka mbajtur edhe mbledhjen e Këshillit Drejtues, ku janë miratuar disa pika të rendit të ditës, ndër to edhe shpallja e vitit zgjedhor të SBASHK-ut, në Shoqatat Sindikale, nivelet komunale, universitete dhe nivele arsimore.



Mbajtja e zgjedhjeve në Shoqata Sindikale fillon nga 1 marsi dhe përfundon më 15 maj 2025, derisa u kërkua që në secilin kuvend zgjedhor të Shoqatave Sindikale, të merr pjesë edhe kryetair i SKAP-it të komunës përkatëse. Ndërsa në nivele komunale dhe universitete zgjedhjet të kryhen deri më 31 korrik 2025. SBASHK vendosi po ashtu afate kohore edhe për mbajtjen e zgjedhjeve në nivelin arimor, në atë fillor, të mesëm të ulët dhe të

mesëm të lartë, ku u parapa që zgjedhjet të përfundojnë më së largu deri më 15 tetor 2025.



Zgjedhjet e rregullta në SBASHK u miratuan njëzëri nga Këshilli Drejtues, derisa në këtë takim u vendosën edhe disa pika të rendit të ditës.

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut vendosi po ashtu për numrin e pushuesve për vitin 2025 të cilët tradicionalisht pushojnë në mënyrë të organizuar në bregdetin shqiptar. Në Këshill u propozua të ruhet numri i pushuesve, ku vitin e kaluar ishin 420 pushues duke përfshirë edhe komisionin organizativ.



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, mori vendim për përgatitjet për Ditën e Mësuesit dhe Shkollës Shqipe, aktivitet dhe ndarja e mirënjohjeve për të pensionuarit-anëtarë të SBAHK-ut gjatë vitit të fundit, etj.

SBASHK ndau mirënjohje për të gjithë anëtarët e saj të pensionuar në sistemin e arimit në Kosovë

Komuna	Numri i të shpërblyerve me Mirënjohje
Deçan	7
Dragash	5
Ferizaj	29
Gjakovë	27
Gjilan	18
Glllogovc	14
Istog	14
Junik	2
Kaçanik	10
Kamenicë	10
Klinë	9
Leposaviq	1
Lipjan	16
Malishevë	21
Mamushë	4
Mitrovçë	13
Obiliq	2
Pejë	38
Podujevë	20
Prishtinë	9
Prizren	46
Rahovec	16
Shtërpçë	3
Shtime	3
Skenderaj	12
Suharekë	10
Universitetet	6
Viti	16
Vushtrri	4
Qendra e Studentëve	4

SBASHK gjatë këtij vitit ka përgatitur 389 mirënjohje për anëtarët e pensionuar nga 1 prilli 2024 deri më 31 mars 2025, derisa këto mirënjohje u shpërndanë nga kryetarët e Sindikatave Komunale të Arimit Parauniversitar (SKAP).

Më poshtë mund të gjeni numrin e mirënjohjeve për secilën komunë si dhe disa pamje nga ceremonitë e shpërndarjes së mirënjohjeve për mësimdhënës janë të ilustruara me foto.

Tabela me numrin e anëtarëve të SBASHK-ut të shpërblyer për kontributin e dhënë në arsim e të cilët janë pensionuar nga 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025 sipas komunave.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

